



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJE
SEKTORI I BURIMEVE NJERZORE

B.Curri, më 17.08.2018

**SHPLLJE PËR NËPUNËS CIVIL,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**Lloji i diplomës “Shkenca ekonomike ose juridike ” niveli minimal i diplomës
“Master Profesional”**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, Bashkia Tropojeshpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionet:

- **1 Specialist per prokurimet publike. ne sektorin juridik**

– **kategoria IV-a.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!
Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

- Per levizjen paralele eshte 10 dit nga data e shpalljes ne portalin e sherbimit kombetare te punesimit
- Për ngritjen në detyrë është 15 dit nga data e shpalljes në portalin e shërbimit kombëtar te punesimit

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

-Hartimi i thirrjeve për tenderat për prokurimet publike dhe organizimi i procesit të marrjes së ofertave përgjegjës për marrëdhënjet kontraktuale me furnitorët dhe kontrollin e përbushjes efektive të kushteve të kontratës nga ana e furnitorit me konkretishte :

- 1-Ne bashkëpunim me njerëzit e tjerë hartojmë kushtet kryesore teknike të thirrjes së tenderave
- 2-Merret me procedurën e prokurimit.
- 3-Organizojmë procesin e shqyrtimit dhe analizimit të ofertave
- 4-Hartojmë kriteret ligjore të kontratës përfundimtare.
- 5-Komunikojmë me fituesin e tenderit dhe monitorojmë realizimin e kontratës.
- 6-Është përgjegjës për dërgimin e keshillave, udhëzimeve dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nenligjore në fushën e prokurimeve publike, me qëllim zbatimin e saktë të dispozitave ligjore në fuqi.
- 7-Përgjegjës për kryerjen në kohë dhe cilësi të inspektimit të dosjeve dhe raportimin për monitorimin e procedurave të prokurimit, në përputhje me legjislacionin.
- 8-Kryen punë specifike të specialitetit që kanë të bëjnë me rregullat e prokurimeve publike brenda rregullave, ligjeve dhe udhëzimeve të përgjithshme
- 9-Realizojmë detyrat në përputhje me politikat e institucionit me standartet administrative dhe procedurat teknike, si dhe duke mbajtur parasysh praktikën më të mirë profesionale.
- 10- Planifikojmë dhe përbushim detyrat e ngarkuara në mënyrë profesionale dhe të pavarur.
- 11-Zbatojmë rekomandimet apo sugjerimet e epurve me qëllim përmirësimin e praktikave apo procedurave në fushën e prokurimeve publike
- 12-Kryen çdo detyrë tjetër që i caktohet nga përgjegjësi i sektorit gjithmonë në lidhje me fushën e veprimtarisë të sektorit ku bën pjesë dhe legjislacionin në fuqi.
- 13-Raporton dhe përgjigjet direktë para përgjegjësit të sektorit juridik dhe veprimtaria e tij ndikon dhe reflektohet direktë në të gjithë veprimtarinë e sektorit juridik dhe prokurimeve publike.
- 14-Kryen të gjitha detyrat që përcaktohen në rregulloren e brendshme të institucionit që ka të bëjë me funksionin e tij

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori, (sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar) (niveli i pagës VI-a),
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të kenë vlerësimin e fundit pozitiv (mirë ose shumë mirë) të plotësuar nga institucioni në përputhje me VKM nr. 109 dt.26.2.2014 “Për vlerësimin e punës së nëpunësve civilë” i ndryshuar me VKM nr.252 dt.30.03.2016.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “ Master Profesional” në degën Shkenca ekonomike ose juridike , edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.*(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).*
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 (një) vite,në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucione tregtare Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- c) Të njoh mir programet e punes ne kompjuter.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Bashkise Tropoje, dokumentet si më poshtë:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni qe nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen në sekertarinë e Bashkise Tropoje dorazi ose me postë, brenda dates 27.08.2018

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 29.08 .2018, Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkise Tropoje do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkisë Tropolje ,nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- 3-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” , i ndryshuar
- 4-Kodin e Procedurave Administrative;
- 5-Ligjin nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”,
- 6- Ligji nr 9643 dt.20.11.2006 “Per prokurimet publike”i ndryshuar
- 7-VKM nr 1 dt.10.01.2007 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”
- 8-vKM nr.914 dt.29.12.2014 ”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Bashkia Tropoje do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar të Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- Pranimi në shërbimin civil

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- d) Të jetë shtetas shqiptar;
- e) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- f) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- g) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- h) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- i) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- j) Të zotërojnë diplomë të nivelit “ Master Profesional” në degën Shkenca ekonomike ose juridike , edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.(Diplomat të

cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).

- k) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 1 (një) vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucione tregtare
Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupë.
- l) Të njoh mirë programet e punës në kompjuter

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në sekretarin e Bashkis Tropoje , brenda datës 31.08.2018.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 10.09.2018, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Bashkis Tropoje do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4**FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- 1-Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- 2-Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- 3-Ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;i ndryshuar
- 4-Kodin e Procedurave Administrative;
- 5-Ligjin nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”,
- 6- Ligji nr 9643 dt.20.11.2006 “per prokurimet publike”i ndryshuar
- 7-VKM nr 1 dt.10.01.2007 “per miratimin e rregullave te prokurimit publik”
- 8-vkm nr.914 dt.29.12.2014 ”per miratimin e rregullave te prokurimit publik”

2.5**MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë qe konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al)
<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6**DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njesia e menaxhimit burimeve njerzore Bashkise Tropoje do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.

NJESIA E MENAXHIMIT BURIMEVE NJERZORE